



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. .... Prot  
*Lutemi referoni këtë numër në përgjigje*

Tiranë, më \_\_\_/ \_\_\_/ 2022

# RAPORT VJETOR 2021

## PËR

## **GJËNDJEN, SHFRYTËZIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE SIGURINË E DIGAVE DHE DAMBAVE NË SHQIPËRI**



Tiranë, Mars 2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

## PËRMBAJTJA

- 1. Të Përgjithshme**
- 2. Baza Ligjore**
- 3. Gjëndja aktuale e digave të mëdha dhe dambave**
- 4. Mirëmbajtja, Monitorimi, dhe Siguria e digave dhe dambave**
- 5. Programi dhe Aktivitetet e KKDM gjatë vitit 2021**
- 6. Përfundime dhe Rekomandime Kryesore**

Shtojcat:

- Shtojca 1 - Rregjistri Kombetar për digat e mëdha në Shqipëri për vitin 2021
- Shtojca 2 - Harta e Vendndodhjes së digave të mëdha në Shqipëri për vitin 2021
- Shtojca 3 - Lista e Shfrytëzuesve të Digave të Mëdha në Shqipëri për vitin 2021
- Shtojca 4 - Grafiku i shpërndarjes së digave të mëdha sipas prefekturave
- Shtojca 5 - Programi i Punës së KKDM për vitin 2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

## 1- Të Përgjithshme

Qëllimi i përgatitjes së këtij raporti vjetor është për të informuar në mënyrë të plotë Këshillin e Ministrave për gjendjen e digave dhe dambave dhe për të dhënë konkluzionet dhe sugjerimet perkatese per ecurine normale dhe permiresimet e nevojshme ne kete sektor te rendeishem per ekonomine e vendit

Njekohesisht mendojme qe permes ketij Raporti te behet sensibilizimi I Institucioneve perkatese dhe shfrytezuesit e digave te medha per vlerat e medha ekonomike qe kane ne administrim si dhe per rrjedhojat e renda qe mund te kete nga mungesa e mirembajtjes, kontrollit dhe monitorimit te tyre.

Ne kete raport do te jepet ne menyre te detajuar nje informacion mbi gjendjen e digave te medha jo vetem sipas informacioneve te ardhura nga shfrytezuesit e tyre por edhe nga shqyrtimi ne vend i shume prej tyre nga antaret e Komitetit Kombetar te Digave te Medha (KKDM)

Deshirojme te theksojme rëndesinë e madhe dhe te vecante qe ka sektori I monitorimit, kontrollit, shfrytezimit dhe Operimit te sigurt te digave në administrimin e ujrave për prodhimin e energjisë ujore, ujitjen e tokave bujqesore, mbrojtjen nga permbytjet, furnizimin me uje, ekonomine e rritjes se peshkut si dhe te prodhimit te energjise diellore. Që nga viti 1957 kur ka filluar ndertimi I diges se pare te madhe ne vendin tone, janë ndërtuar **682 diga të mëdha dhe të vogla** për qëllime të ndryshme por me te rëndesishme kane qene prodhimi i energjisë ujore dhe Ujitja e tokave. Per rolin e rëndesishem qe luajne ne ekonomine shqiptare, **konkluzioni per rritjen e sigurise se tyre dhe permiresimin e operimit, mirembajtjes dhe kontrollit te tyre eshte imediat dhe kerkon nje vemendje te shtuar nga te gjithë aktoret e perfshire ne kete sektor. E theksojme kete konkluzion per faktin se aktualisht, me se 95 % e digave te ujitjes nuk kane sisteme monitorimi dhe asnje plan te gadishmerise ne rastet e emergjencave civile.** Per te gjithë rezervuaret e krijuar nga digat e medha qe perdoren per ujitje nuk ka matje te volumeve faktike te ujit qe prej 30 vitesh ne nje kohe qe sipas kerkesave ligjore keto volume duhet te maten te pakten nje here ne 10 vjet. Kjo mungese matjesh, sjell si rezultat mosnjohjen si duhet te kapaciteteve te tyre per ujitjen e tokave dhe probleme ne menaxhimin e ketyre ujrave per qellime bujqesore. Sipas nje studimi te fundit te eksperteve te Bankes Boterore, rezulton se kapaciteti I projektuar per rezervimin e ujit ne ujembledhesat e krijuar nga keto diga ka qene afro 560 milion m3 dhe aktualisht ky kapacitet eshte me pak se 300 milion m3 per sezonin e ujitjes i cili sherben per ujitjen e afro 360 000 ha toke nga me se 700 000 ha toke qe ka vendi yne. Theksojme se sipas specialisteve kerkesat per ujitje jane per me shume se miliard m3 uje. Bazuar tek studim, rezulton se afro 400 diga te medha dhe te vogla kane probleme teknike te ndryshme per te cilat kerkohet te nderhyhet sa me shpejt te jete e mundur sepse prezenca e ketyre problemeve rezulton ne humbjen e sasive te medha te ujit qe mund te perdoren per ujitje. Gjithashtu, Sipas vleresimeve te kryera nga MBZHR rezulton se afro 70 diga kane dale jasht funksionit dhe kerkohet nderhyrje per dekomisionimin e tyre ne perputhje me kerkesat e standarteve teknike dhe mbrojtjes se mjedisit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Sipas Rregjistrit Kombëtar të Digave të Mëdha të hartuar dhe aprovuar nga Komiteti Kombëtar I Digave të Mëdha (KKDM), në vendin tonë aktualisht janë në shfrytëzim deri në fundin e viti 2021, **351 diga të mëdha** të përcaktuara sipas Ligjit Nr.8681, datë 02.11.2000 “Per projektimin,

Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e digave dhe Dambave” dhe të rregjistruara në Komisionin Ndërkombëtar të Digave të Mëdha (ICOLD). Lista e këtyre digave me të dhënat teknike kryesore të tyre jepen në shtojcën Nr. 1 të këtij raporti vjetor. Këto vepra janë të rëndësishme së vecantë dhe kërkojnë marrjen e tërësisë së masave organizative, teknike dhe financiare që të garantojnë shfrytëzimin normal të tyre, jetëgjatësinë dhe mosçënimin e të tretëve në fazën e ndërtimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjen e tyre.

Prej Vitit 1964, Shqipëria vazhdon të jetë antare me të drejta të plota në Komisionin Ndërkombëtar të Digave të Mëdha (ICOLD) ku merr pjesë dhe jep kontributin e saj zyrtar në mënyrë aktive në të gjithë proceset e bashkëpunimit teknik dhe institucional me aktorët ndërkombëtarë të këtij sektori

**Sipas Rregjistrit kombëtar të ICOLD, Shqipëria është në vendin e 19 në botë për sasinë e përgjithshme të digave të mëdha dhe renditet në vendin e parë në Europë për numër të digave të mëdha për 1000 km<sup>2</sup> si dhe për numër të digave të mëdha për 1 milion banorë.**

Në Shqipëri aktualisht janë **10 diga shumë të mëdha me lartësi mbi 60 m të cilat shfrytëzohen dhe përdoren për prodhim hidroenergjie, Ujitje dhe Furnizim me ujë**. Ato janë digat me rrezikun me të lartë për dëmtime në ekonomi dhe në njerëz në rastet e ndonjë ngjarje natyrore, prishje të mundshme të ndonjë dige nga faktore natyrore apo human. Sipas analizave të riskut të kryera nga ekspertet të huaj dhe vendas, digat shumë të mëdha me rrezikun më të madh për dëmtime apo humbje jete janë Digat e Kaskadës së lumit Drin, Digat e kaskadës së lumit Mat dhe Fan si dhe Digat e kaskadës së lumit Devoll, prishja e mundshme e të cilave mund të rrezikoj afro 300 000 njerëz. Ky rrezik shtohet dita ditës edhe për faktin e zhvillimit urban të pakontrolluar në zonat poshte digave. Kjo situatë kërkon në mënyrë urgjente përgatitjen e hartave të permbytjeve, Planet e gadishmerisë në rastet e emergjencave civile si dhe funksionimin e ekipeve të monitorimit të tyre nga shfrytëzuesit e digave në baze të legjisllacionit në fuqi.

Aktualisht vihet re përdorimi i këtyre rezervuarëve për qëllime transporti, atraksione urbane dhe turistike, zhvillimin e sporteve ujore si dhe përmirësime të mikroklimës në shumë zona me klime të ftohtë dhe të ashpër gjatë dimrit

Digat dhe rezervuarët e krijuar prej tyre përbejnë një pasuri kombëtare e cila mendojmë se duhet vlerësuar për rëndësinë që ka dhe vlerat e shumanshme që jep. Duke patur parasysh edhe faktin se uji është një pasuri që rrjedh gjithmone dhe perseritet çdo vit, vlera e këtyre veprave është shumë here me e madhe dhe kërkon një administrim të vecantë me disipline teknike rigorozë që të garantojmë shfrytëzimin racional të tyre dhe rritjen e jetëgjatësisë së shfrytëzimit të tyre.

Theksojmë se për të ushtruar kontrollin e duhur në këte sektor të rëndësishëm kërkohet një forcim i kapaciteteve të institucioneve të përfshira në këte sektor si krijimi i Inspektoriatit teknik të digave të kerkuara në legjisllacion, riorganizimi i sekretariatit kombëtar të digave si dhe rishikimi dhe përditesimi i bazës ligjore dhe nenligjore për sigurinë e digave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

## 2-Baza Ligjore

Për përgatitjen e Raportit Vjetor të vitit 2021 për Gjëndjen, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe Sigurinë e Digave dhe Dambave në Shqipëri, KKDM është bazuar në legjislacionin në fuqi si më poshtë:

### Aktet Ligjore

- *Ligji Nr. 8681, dt. 02.11.2000 “Për Projektimin, Ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave” I përditësuar në dt.14.02.2013*
- *Ligji Nr. 45, datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”*
- *Ligji Nr. 10431, date 09.06.2011 “ Për Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji Nr. 111/2012, date 15.11.2012 “Mbi Menaxhimin e integruar të Burimeve Ujore”*
- *Ligji Nr. 242, date 09.03.2017 “Per Admnistrimin e Ujitjes dhe Kullimit”*

### Vendimet e Këshillit të Ministrave

- *VKM Nr. 147, dt. 18.03.2004 “Për Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe Dambave*
- *VKM Nr. 4, dt. 18.07.2003 “Për Kërkesat e dokumentacionit Teknik dhe Ligjor që duhet të përmbajnë Dosjet teknike/ pasaportat e digave*
- *VKM Nr. 1108, dt. 30.12.2015 “Për Transferimin e sistemeve dhe digave të Ujitjes tek Pushteti Lokal”*
- *VKM Nr. 414, dt. 08.07.2021 “ Per miratimin e procedurave dhe kriterëve te ndarjes dhe perdorimit te fondit te kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile*

### Udhezime dhe rekomandime te KKDM dhe te ICOLD

- *Udhezimet e KKDM per*
  - *Hartimin e Rregulloreve te shfrytezimit te digave*
  - *Monitorimin e digave pas termetit*
  - *Pregatitjen e pasaportave te digave dhe dambave*
  - *Pregatitjen e Planeve te gadishmerise ne rastet e emergjencave civile te shkaktuara nga prishja e mundshme e digave*
- *Buletinet e ICOLD per projektimin, ndertimin, shfrytezimin dhe sigurine e digave te medha*



### 3-Gjendja aktuale e digave të mëdha dhe dambave

Bazuar në Raportet vjetore të ardhura nga 38 Shfrytëzues të digave (60 % e numrit total të tyre), si dhe nga inspektimet dhe kontrollet e kryera gjatë vitit 2021 nga KKDM dëshirojmë t'ju informojmë se një pjesë e digave të mëdha që përdoren për Ujitje janë me probleme të ndryshme teknike në trupin e digës, në shkarkuesit katastrofik si dhe në sistemet e marrjes së ujit.

Theksojmë se më se 45 % e digave të mëdha kanë si **problem shqetësues vjetërsinë e tyre**. Me se 110 diga të ujitjes të cilat janë me material vendi, janë me se 50 vjecare të vjetra në një kohë që projektimi i tyre sipas standarteve të kohës kanë qenë të projektuar për periudha deri në 60 vjet. Afro 70 diga të mëdha kanë dale jashtë funksionit dhe kërkojnë vleresim teknik në përputhje me standartet teknike dhe rekomandimet e ICOLD për dekomisionimin e tyre

**Në më se 90 % të digave të mëdha ka mungesë të mirëmbajtjes së vazhdueshme nga shfrytëzuesit e digave, mungesë të sistemeve të monitorimit dhe kontrollit të tyre, mungesë të matjeve të volumeve aktuale të ujit në rezervuarët e krijuar nga këto diga si dhe mungesë të Planeve të gadishmerisë në rastet e emergjencave civile dhe të hartave të permbytjeve duke mos respektuar kërkesat e legjislativës në fuqi. Megjithatë nga buxheti I shtetit, gjatë vitit 2021 janë dhënë mjaft fonde në këtë drejtim, rezultojnë se këto fonde nuk janë përdorur nga bashkitë që janë shfrytëzues të këtyre digave**

**Në më se 95 % të digave të mëdha mungojnë sistemet online në kohë reale të alarmit.**

Megjithatë deri më sot nuk ka patur asnjë dëmtim serioz apo prishje totale të digave prej dheu, dëmtimet e shfaqura në disa prej tyre gjatë vitit 2021 gjatë sezonit të rreshjeve si Diga e Paskuqanit/Kamëz, Harvalës/Selenicë, Zall Herr dhe Farke/Tiranë, Manskuria/ Kavaje, Tapize/Krujë, etj janë shënja të qarta për vazhdim të mundshëm të dëmtimeve dhe rrezikut të rreshqitjeve të dherave në anën e poshtme të tyre në rast se nuk merren masat e duhura për rehabilitimin e tyre në kohën e duhur. Rehabilitimet e kërkuara vetëm në momentin e cfaqjes në përmasa të pariparueshme për rreshqitjet që ndodhin gjatë sezonit ujëshumë apo rehabilitimet e shkarkuesve në këto periudha nuk i shërbejnë sigurisë së digës por janë vetëm zgjidhje emergjente për të shmangur pasojat e rrezikshme që lidhen me sigurinë e tyre dhe me sigurinë e banorëve që ndodhen poshtë tyre. Theksojmë se shfrytëzuesit e digave duhet të mendojnë për rehabilitime të tilla dhe monitorim të situatës në periudhat e verës dhe të vjeshtës.

Procesi i transferimit të shfrytëzimit, operimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të digave të mëdha që prej 7 viteve nuk ka sjellë përmirësime në shfrytëzimin, monitorimin dhe Sigurinë e tyre. Ky proces në 80 % të rasteve është kryer pa procesin e dorëzimit të dosjeve teknike dhe pa vleresim të plote të aseteve tek shfrytëzuesit e digave nga MBZHR, pa trainime për ekipin e Inxhinierëve të digave, pa dorëzim të sistemeve të monitorimit të digave si dhe pa instalim të ndonjë sistemi alarmi apo përgatitje të hartave të permbytjeve dhe plane të gadishmerisë në rastet e emergjencave civile. Këto kërkesa ishin detyrime ligjore për të cilat MBZHR duhet të kryente për të plotësuar një proces korrekt, profesional dhe ligjzbatues. Kjo situatë nuk justifikon mungesën e masave nga pushtetet lokale për përgatitjen e këtyre dokumentave të kërkuara nga legjislativi në fuqi.

Aktualisht, sipas informacioneve të ardhura pranë SKDM, vetëm 50 dosje teknike të projektit origjinal për afro 50 diga të mëdha që përdoren për ujitje ndodhen në Arshiven e MBZHR.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Cilesia e ketyre projekteve eshte mjaft e dobet dhe kerkoet nje proces teknik profesional per pregatitjen e vizatimeve teknike dhe dosjeve perkatese sipas standarteve teknike. Për transferimin e dosjeve teknike te plotesuara si dhe përditësimin me projektet e rehabilitimit të kryer për disa diga, mendojmë se duhet të kryhet një proces i përbashkët në bashkëpunim me MBZHR dhe Shfrytëzuesit aktuale të digave te Ujitjes si dhe prefekturave perkatese. Ky proces duhet të shoqerohet edhe me një proces trainimi të ekipit teknik që është përgjegjës për monitorimin dhe sigurine e tyre.

Gjithashtu, në realitetin e shfrytëzimit të digave nga Koncesionare të HEC dhe shfrytëzues të digave të mëdha, ka shume raste të mosrespektimit të kërkesave të legjislacionit të sipercituar (Ligji Nr.8681, Datë 02.11.2000). Këto ndodhin edhe me institucionet shtetërore të rëndësishme. Raste tipike mund të përmenden mosplotësimi i kërkesave të ligjit në lidhje me aprovimin e fazave të mbushjes se rezervuarit te krijuar nga ndertimi i digës Lumzi, rastet e mungeses së rregulloreve të shfrytëzimit të digës sipas udhëzimeve të KKDM (rasti i Bashkise Tirane si dhe 5 shfrytëzuesve private te digave qe perdoren per prodhim energjie.

Gjithashtu, gjatë vitit 2021 janë kryer disa punimeve rehabilitimi në disa diga të mëdha sic është Diga e Janjarit, diga e Mursisë, diga e Shtodrit, diga e Paskuqanit dhe diga e Spitalles.

KESH ka perfunduar punimet e rehabilitimit per sistemet e shkarkimit ne digen e Fierzes dhe te Komanit, Rehabilitimin e Masivit shkembor tek kulla e ekuilibrit ne afersi te diges se Komanit, Instalimin e sistemeve te paneleve diellore ne digen e Qyrsaqit.

Per te gjitha punimet e rehabilitimit te kryera nga shfrytëzuesit e digave nuk ka informacione ne lidhje me mbikqyrjen e punimeve apo kolaudimin e ketyre punimeve sic kerkoet ne legjislacionin perkates per sigurine e digave. Theksojme se në **bazë të ligjit për këto punime kërkohet miratim nga KKDM për Mbikqyrësin e punimeve te zgjedhur nga Shfrytëzuesi si dhe përfaqësues të Inspektoriatit Teknik te Digave (ITD) gjatë kryerjes së punimeve. Mungesa e Insitucionit të ITD i cili akoma nuk eshte krijuar nga MIE si strukture e posacme brenda SKDM, ka krijuar probleme** jo vetem per kontrollin e gjendjes se digave apo punimeve te kryera ne to por edhe për marrjen e masave të kërkuara nga ligji në fuqi gjate kontrollit te punimeve ne terren si dhe kontrollit te dokumentacionit te kerkuar qe duhet te jete prane shfrytëzuesit te digave. Për rrjedhoje, KKDM do te kerkonte nje zgjidhje te shpejte dhe një riorganizim te SKDM dhe ITD e cila do të përmirësoje ndjeshem kontrollin me cilësi të këtyre veprave që janë të një rëndësie të vecantë.

Në lidhje me gjendjen aktuale të dambave theksojmë se shfrytëzuesit e tyre dhe AKBN nuk kanë dhenë asnje informacion në lidhje me to megjithë kërkesat e përsëritura nga KKDM zyrtarisht në drejtim të MIE, AKBN dhe fabrikave te pasurimit te kromit dhe bakrit ku jane keto damba

Sipas informacione të mbledhura gjatë kontrolleve në terren, nuk janë vënë re probleme teknike të mëdha por është vënë re se nuk ka një inventar të plotë të dosjeve teknike të tyre, kapaciteteve që kanë, rregulloreve të shfrytëzimit të tyre apo skemave teknologjike të shfrytëzimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

## 4- Mirëmbajtja, Monitorimi dhe Siguria e digave dhe dambave nga Shfrytëzuesit e digave

Bazuar në Raportet vjetore të ardhura nga Shfrytëzuesit si dhe nga inspektimet dhe kontrollet e kryera gjatë vitit 2021 nga KKDM dëshirojmë t'ju informojme se procesi i mirëmbajtjes, monitorimit dhe sigurisë së digave të mëdha në përgjithësi ka shumë të meta dhe mungesa në kryerjen e tyre

Procesi i kontrollit, monitorimit dhe Sigurisë së digave paraqitet me mirë në Digat shumë të mëdha që shfrytëzohen për prodhim energjisë. Konkretisht, Shfrytëzuesit e digave KESH, Devolli HP, Ayen, Kurum, etj kanë një sistem të plotë të kontrollit dhe monitorimit modern dhe në kohë reale të digës të pajisur me sistemet e duhura të kontrollit dhe monitorimit të saj.

Këto shfrytëzues kanë të organizuar edhe Njësitë teknike të shfrytëzimit dhe monitorimit të digave. Megjithatë dëshirojmë të theksojmë se procesi i kompletimit të instalimit të sistemeve të alarmit në zonat urbane poshtë digave si dhe në digat e kaskades së lumit Drin, kaskades së lumit Devoll dhe kaskades së lumenjve Fan dhe Mat si digat me të rëndësishme të vendit duhet të perfundojë sa më shpejt. Këto sisteme duhet të jete sisteme bashkëkohor dhe me standartet me të larta teknike europiane,

Nga ana tjetër, vihet re se shfrytëzues private të digave të mëdha për prodhim energjie (digat e Lumzi, Murdhar, Okshtun, Osoja, Helmes, Belesova, etj) kryejnë një kontroll të thjeshtë vizual të gjëndjes dhe nuk kanë të instaluar sisteme monitorimi apo sisteme alarmi për rastet e emergjencave civile në zonat poshtë digave

**E njëjta situatë është edhe për Digat e mëdha që shfrytëzohen nga MBZHR si dhe digat e mëdha që shfrytëzohen nga pushtetet lokale. Sipas raportimeve dhe kontrolleve në vend, rezultoi se në mbi 98 % të digave të ujitjes që shfrytëzohen nga MBZHR dhe Bashkitë nuk ka të instaluar sisteme të monitorimit të digave apo sisteme alarmi. Në mënyrë të vecantë vihet re se bashkitë e 5 qarqeve (qarku Tiranë, Durrës, Gjirokastër, Berat dhe Korçë) që shfrytëzojnë me se 60 % të digave të mëdha jo vetëm që nuk kryejnë monitorim apo mirëmbajtje të digave por nuk kanë përgatitur asnjë hartë të përmbajtjeve në zonat poshtë tyre sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi të pershtatur me kushte aktuale të zonës poshtë digave. Kjo problematikë bëhet më e vecantë duke patur parasysh se popullsia në këto zona është shtuar shumë dhe rreziku është imediat dhe mjaft i madh. Theksojmë se në shumicën e digave që shfrytëzohen nga bordet e kullimit të MBZHR dhe të këtyre bashkive nuk kryhen proceset e mirëmbajtjes të kërkuara sipas legjislacionit në fuqi gjë e cila ka sjelle mbushjen e digave me peme dhe shkurre që jo vetëm demtojnë trupin e digës por krijojnë premisa për rritjen e filtrimeve të ujit dhe uljen e jetegjatesisë së digave**

Një problem tjetër që vihet re tek shumë bashki të vogla është mungesa e stafëve teknike për monitorimin dhe sigurinë e digave.

Për të dhëne një pasqyrë më të detajuar të situatës, po përshkruajmë këtë proces sipas tipit të digave, përdorimit të tyre, rëndësisë dhe sigurisë që duhet të trajtohen dhe problematika që janë hasur si më poshtë,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- **Digat e mëdha që përdoren për prodhim energjie**

Sipas rregjistrimit të KKDM, në vendin tonë aktualisht janë **24 diga të mëdha** nga të cilat 6 diga të mëdha janë pjesë e Kaskades së lumit Drinit të shfrytëzuara nga KESH, 3 diga janë pjesë e kaskadës së lumit Devoll që shfrytëzohen nga Shoqëria DEVOLLI HP (Moglicë dhe Banjë) dhe shoqëria Favina (Osoja), 4 diga janë pjesë e kaskadës së lumenjve Mat dhe Fan të shfrytëzuara nga kompanitë AYEN, KURUM, LUMZI, etj

- **Digat e mëdha për prodhim energjie të kaskadës së lumit Drin të administruara nga KESH.**

Kontrolli, Monitorimi dhe siguria e tyre kryhet nga ekipe teknike të kualifikuara dhe sipas rregulloreve përkatëse të shfrytëzimit. KESH jo vetëm kryen një kontroll vizual sipas kërkesave teknike por ka instaluar në cdo digë sistemet bashkëkohore përkatëse të monitorimit si më poshtë:

- Sistemi i monitorimit gjeodezik,
- Sistemi i monitorimit gjeologjik,
- Sistemi i monitorimit sizmik,
- Sistemi i monitorimit hidraulik
- Sistemi i monitorimit Hidrometeorologjik
- Sistemi i monitorimit të masiveve rrëshqitëse në Porave, Gropaj në HEC Fierzë dhe tek zonat e masiveve rrëshqitëse tek kullat e ekuilibrit në digen e Komanit.

KESH ka hartuar rregulloret për shfrytëzimin e digave dhe shkarkimeve në rastet plotave të mëdha. Ne vitin 2015, KESH ka përgatitur edhe hartat e përmbytjeve për zonën poshtë digave dhe në vitin 2019 kanë instaluar sistemet e alarmit tek digat ( faza e pare). Ne vitin 2021 janë perditesuar Planet e gadishmërisë në rastet e emergjencave civile të shoqëruar me skenarët sipas kërkesave të ligjit si dhe të bazuar në të dhënat e matjeve të volumeve të ujit dhe të sedimenteve në rezervuaret e krijuar.

Bazuar në studimet e mëparshme, në matjet e fundit të volumeve të ujit në të 3 ujembledhësit e krijuar si dhe në grumbullimin e të dhënave të shumta gjatë 35 viteve të fundit në lidhje me menaxhimin e integruar të ujërave të kaskadës si dhe problematikat që janë hasura nga përmbytjet në vitet 2010 dhe 2018, KKDM sugjeron që KESH duhet të ndërmarrë inisiativa profesionale të bazuar në ekspertizën e thelluar dhe të studjuara për përmirësimin e menaxhimit të integruar të Kaskadës dhe ngritjen në një stad bashkëkohor dhe eficient të menaxhimit të prurjeve të mëdha në kaskadën e lumit Drin.

Keto ekspertiza mund të mbështeten në Udhezimet dhe rekomandimet e dhëna në buletin e ICOLD Nr. 186 “Per Menaxhimin e Integruar te Digave te Kaskades”, buletin Nr. 187 “Per Menaxhimin e rrezikut dhe Permbytjeve”, apo buletini Nr. 189 “Per Rrezikun e informuar nga vendimmarresi per Sigurine e digave”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Duke u bazuar në të gjitha të dhënat dhe studimet e deri sotme të kryera nga KESH, **KKDM është e mendimit se ka ardhur koha të kryhet një rishikim profesional nga eksperte me përvojë dhe i përshtatur me kushtet e sotme të menaxhimit dhe ndryshimeve klimatike i Rregullores së Shkarkimit të Plotave të mëdha ne kaskaden e lumit Drin i përgatitur ne vitin 1988. Rishikimi i rregullores duhet te kete si fokus rritjen e sigurise se digave te kaskades se lumit Drin, operimin optimal te integruar te te gjithë ujembledhesave te kaskades si dhe përgatitjen e moduleve te operimit duke kombinuar perfitimet nga hidroenergjia me zvogelimin e rrezikut nga permbytjet dhe perfitimet per kulturat bujqesore ne tokat qe ndodhen ne zonat poshte digave te HEC Vau I Dejes.**

**Kjo kerkese behet edhe me aktuale ne kushtet e fillimit te projektit per HEC Skavicen, ndertim i te cilit do te kerkoj menjehere miratimin e nje rregullore te re te menaxhimit te integruar te kaskades ku do te perfshihen edhe procesi i shkarkimit te plotave te medha si dhe bashkepunimi me shfrytezuesit e digave mbi lumin Drin I zi ne te dy anet e kufirit. Ne kuader te hartimit dhe zbatimit te projektit te HEC Skavices, KKDM sugjeron fillimin e biseimeve me palen maqedonase te udhehequr nga Komisioni nderkufitar i ujrave jo vetem per shfrytezimin e perbashket te ujrave te basenit te Drinit por edhe per bashkepunimin institucional nderqeveritar ne lidhje me sigurine e digave te kaskades se lumit Drin dhe ne menyre te vecante per efektet e shfrytezimit te diges se Spillje ne operimin e diges se HEC Skavices.**

Rishikimi i Rregullores duhet të bëhet me pjesmarrjen e ekspertëve të fushës dhe në bashkëpunim me të gjithë aktoret që menaxhojnë kaskaden e lumit Drin (Keshilli i Ministrave, MIE, MBZHR, Prefekurat Shkoder dhe Kukes, Pushteti lokal, Ministria e Mbrojtjes/ Agjencia e Mbrojtjes civile, Agjencia e Menaxhimit te burimeve Ujore, etj) si dhe ekspertë të kualifikuar të fushës në sektorin e digave te medha dhe të menaxhimit të kaskadave të lumenjve..

Theksojme se **Kaskada e Lumit Drin për vetë tipin e digave të ndërtuara, kompozicionin dhe basenet e krijuara, kapacitetet e instaluara të energjisë, dinamikën e përdorimit për shfrytëzimin e kësaj energjie, peshën specifike në prodhimin e energjisë dhe impaktin pozitiv në ekonomine e vendit është Unike në Europë.** Gjithashtu, duke patur parasysh edhe faktin e Rrezikut të lartë human dhe ekonomik në raste të ndonjë dëmtimi të mundshëm natyror, do të kërkonim që kjo **Kaskadë të marrë statusin e veprave të rëndësisë shume të vecantë** e cila duhet të shoqerohet edhe me të gjitha masat organizative e teknike përkatëse dhe ekip të vecante e të kualifikuar për monitorimin dhe analizen e të dhenave të marra online në kohë reale për të gjitha digat e kaskadës.

Bazuar në disa studime të mëparshme, KESH ka parashikuar të kryeje edhe matjet batimetrike të volumeve të ujit të tre liqenet sipas rekomandimeve të dhena si dhe të bazuar në gjendjen aktuale të këtyre volumeve duke qenë se sipas matjeve të kryera në vitin 2015, kapaciteti total i ujembledhesit te Fierzes deri ne nivelin maksimal te operimit 296.00 mmnd rezulton te jetë afro 2.2 miliard m3 uje (15 % me pak se volumi prej 2.7 miliard m3 i dhene ne projektin origjinal).

Nga kontrollet e kryera nga ekipi i sigurise se digave ne KESH, një problem që duhet të monitorohet me kujdes të vazhdueshëm ne kohe reale dhe në mënyre online janë filtrimet në bieftin e poshtëm të digës së Komanit, vlerat e të cilave janë shume me të larta se vlerat e rekomanduara nga literatura nderkombetare dhe rekomandimet e ICOLD.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

**KKDM rekomandon që procesi i kontrollit dhe monitorimit të sasisë së ujrave që filtrojnë në anen e poshtme të digës së HEC Koman si dhe turbullësia e tyre në kohë të ndryshme duhet të kryhet në kohe reale, online dhe të dhënat të dërgohen për tu analizuar të paktën çdo javë në Departamentin e Sigurisë së digave. KESH duhet të dërgojë një Raport teknik të vecantë në lidhje me këto filtrime në KKDM dhe MIE çdo 6 muaj. Ky raport duhet të shoqërohet edhe me analizat përkatëse, ecurinë e procesit, konkluzione dhe rekomandimet përkatëse për të ardhmen.**

Gjithashtu, KKDM sugjeron që KESH të kryejë studime me të detajuara dhe të thelluara me metoda bashkëkohore për percaktimin e rrugëve të levizjes së ujrave nga liqeni përmes digës në drejtim të anës së poshtme të saj

- **Tre Digat e mëdha për prodhimin energjie të kaskadës së lumit Devoll të administruara nga Devolli HP/ Statcraft dhe Favina.**

Kontrolli, Monitorimi dhe siguria e digave të HEC Banje dhe HEC Moglice kryhet nga ekipe teknike të kualifikuara dhe sipas rregulloreve përkatëse të shfrytëzimit. Devolli HP/Statcraft jo vetëm kryen një kontroll vizual sipas kërkesave teknike por ka instaluar në çdo digë sistemet bashkëkohore përkatëse të monitorimit si me poshtë:

- Sistemi i monitorimit gjeodezik,
- Sistemi i monitorimit gjeologjik,
- Sistemi i monitorimit sizmik,
- Sistemi i monitorimit hidraulik
- Sistemi i monitorimit Hidrometeorologjik
- Sistemi i monitorimit të masiveve rrëshqitëse në brigjet e rezervuareve dhe afër digave

Devolli HP/ Statcraft jo vetëm ka hartuar rregulloret për shfrytëzimin e digave dhe shkarkimeve në rastet plotave të mëdha e cila është aprovuar nga KKDM por kanë përgatitur edhe hartat e përmbytjeve dhe kanë instaluar në çdo digë sistemet bashkëkohore të alarmit si dhe kanë përgatitur edhe Planet e gadishmërisë në rastet e emergjencave civile të shoqëruar me skenaret sipas kërkesave të ligjit. Këto plane janë përgatitur duke u bazuar në të dhënat e projektit. Në vijim, KKDM kërkon të përgatiten Planet e Gadishmërisë në rastet e emergjencave civile duke u bazuar në të dhënat teknike aktuale për të dy digat duke përfshirë gjendjen aktuale të digave, sistemet e monitorimit dhe të alarmit të instaluar në to sëbashku me rregulloren e operimit dhe të mirëmbajtjes së tyre si dhe të sistemeve të shkarkimit. KKDM ka kërkuar përditësimin e Rregullores së shfrytëzimit të digave bazuar në udhëzimet e reja të dhëna në lidhje me monitorimin e digave pas termetit.

**Gjatë kontrollit dhe monitorimit të digës së Moglicës gjatë vitit 2021 pas mbushjes së parë me ujë të rezervuarit si dhe nga raportet teknike përkatëse të Shfrytëzuesit të digës, KKDM ka vërejtur problematika në lidhje me ulje lokale në kreshtes të digës së Moglicës si dhe disa ulje me të mëdha në pjesën e sipërme të trupit të digës të cilat për mendimin e KKDM janë problematikë dhe duhet të monitorohen me kujdes të vazhdueshëm nga ekipi teknik i shfrytëzuesit të digës.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Për këtë arsye, KKDM e ka ndjekur me perparësi procesin e monitorimit të kesaj problematike si dhe Analizen e kryer nga eksperte të shfrytëzuesit të diges në baze të të ciles ka gjykuar se uljet e vërejtura në kreshten e kesaj dige janë problematike për sa i përket nivelit të uljes, kohës së shkurtër të ndodhur, zonës si edhe konfigurimit të ndodhur.

Për sa më sipër, **KKDM ka marrë në shqyrtim dy here Raportet teknike të hollësishme nga konsulente me përvojë nderkombetare të shfrytëzuesit të digës në lidhje me ecurinë e kësaj ulje dhe dërgimin e informacionit përkatës cdo 6 muaj në rast të një ecurie pa probleme të medha në këte drejtim. KKDM ka kërkuar vazhdimin e procesit të monitorimit dhe të analizës së thelluar të kesaj problematike. Në rastet se nga monitorimi i situatës vihen re perkeqesime, Shfrytëzuesi i Diges duhet të raportojë në kohe reale insticionet përkatëse.**

- **Digat e mëdhe për prodhime energjie në lumin Fan dhe Mat të shfrytëzuar nga AYEN, Kurum dhe Lumzi MC.**

Kontrolli, Monitorimi dhe siguria e diges së Fanit me lartësi 92m kryhet nga ekipe teknike të kualifikuara dhe sipas rregulloreve përkatëse të shfrytëzimit. Kompania AYEN jo vetëm kryen një kontroll vizual sipas kërkesave teknike por ka instaluar edhe sisteme bashkëkohore të monitorimit të digës. AYEN ka hartuar rregulloret për shfrytëzimin e digës dhe shkarkimeve në rastet e plotave të mëdha e cila është aprovuar nga KKDM. Në vitin 2021, Shfrytëzuesi i diges ka përgatitur edhe hartat e përmbytjeve dhe kanë përgatitur edhe Planet e gadishmërisë në rastet e emergjencave civile të shoqëruar me skenaret sipas kërkesave të ligjit. Keto harta përmbytje, llogaritjet e vales shkatërruese dhe Planet e Gadishmerisë në rastet e emergjencave civile janë hartuar bazuar në gjendjen faktike të zbatimit të projektit.

Kontrolli, Monitorimi dhe siguria e digës së Ulzës dhe Shkopetit kryhet nga ekipe teknike të kualifikuara dhe sipas rregulloreve përkatëse të shfrytëzimit. Kompania KURUM jo vetëm kryen një kontroll vizual sipas kërkesave teknike por ka instaluar edhe sisteme të monitorimit të digës të cilat funksionojnë dhe japin të dhëna të rregullta.

KURUM ka hartuar një rregullore për shfrytëzimin e digës dhe shkarkimeve në rastet plotave të mëdha e cila është shqyrtuar në KKDM.

Planet e Gadishmerisë në rastet e emergjencave civile për digat e Ulzës dhe Shkopetit janë përditësuar duke marrë në konsideratë plotesimet dhe nderhyrjet e kryera në digën e HEC Ulzës në vitin 2018.

Kontrolli, Monitorimi dhe siguria e digës së Lumzi nuk kryhet nga ekipe teknike të kualifikuara dhe sipas rregulloreve përkatëse të shfrytëzimit. Kompania Lumzi MC jo vetëm që nuk kryen ndonjë kontroll sipas kërkesave teknike por deri me sot nuk ka dorëzuar ndonjë Raport vjetor në lidhje me gjendjen e diges apo monitorimin e saj. Në digën e Lumzi nuk ka të instaluar sisteme të monitorimit të digës.

Shoqëria LUMZI MC nuk ka hartuar deri me sot ndonjë rregullore për shfrytëzimin e digës dhe shkarkimeve në rastet plotave të mëdha. Planet e Gadishmerisë në rastet e emergjencave civile për digën e Lumzi nuk janë përgatitur akoma. KKDM në një mbledhje të vecante në muajin Nendor 2021 ka marrë në shqyrtim problematikën në digën e Lumzi dhe ka lënë detyrat përkatëse për plotesimin e tyre brenda muajit Mars 2022.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- **Digat e mëdha për prodhim energjie të administruara nga Koncesionarë të tjerë të HEC (Hydroenergy, DITECO, Teodori 2003,etj)**

Bazuar në kontrollet e kryera nga KKDM dhe raportimet e kerkuara nga shfrytëzuesit e digave na rezulton se Kontrolli, Monitorimi dhe siguria e digave të Murdharit, Okshtun, Helmes, Belesove, Liqeni i i zi, etj) nuk kryhet sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe rekomandimeve të ICOLD. Shfrytëzuesit nuk kryejnë monitorimin nga ekipe teknike të kualifikuara dhe sipas rregulloreve përkatëse të shfrytëzimit. Ato kryejnë vetem kontrolle vizual sipas kërkesave teknike.

Asnje prej shfrytëzuesve të mësipërme nuk kanë hartuar një rregullore për shfrytëzimin e digës dhe shkarkimeve në rastet plotave të mëdha. KKDM ka kërkuar zyrtarisht plotësimin e saj me hartat e përmbajtjeve në zonën poshtë digës, llogaritjen e valës shkatërruese, matjet batimetrike për volumin e ujit në rezervuar, Pregatitjen e planeve të gadishmërisë në rastet e emergjencave civile sipas legjislacionit në fuqi të shoqeruar me skenaret sipas kërkesave të ligjit. Te gjitha keto kerkesa nuk jane plotesuar akoma nga keta shfrytezues dhe mungesa e ITD e ben te pamundur zbatimin e sanksioneve te percaktuara ne legjislacionin perkates

- **Digat e mëdha që perdoren për Furnizim me Ujë (Diga e Bovillës dhe e Manskurisë)**

Sipas rregjistrimit të KKDM, në vendin tonë aktualisht janë **dy diga të medha** që përdoren për furnizimin me ujë të Popullsisë urbane në Tiranë dhe Kavajë. Diga më e rëndësishme në këtë grup është diga e Bovillës me lartësi 91 m që përdoret për furnizimin me ujë të qytetit të Tiranës

Kontrolli, Monitorimi dhe siguria e digës së Bovillës kryhet nga ekip teknike i kualifikuara nën administrimin e UKT sipas rregulloreve përkatëse të shfrytëzimit.

Bazuar në Kontrollin e kryer nga një ekip pune i KKDM si dhe në korrespondencën e gjatë të KKDM në lidhje me problematikat e hasura ndër vite për shfrytëzimin dhe Sigurinë e digës së Bovillës, KKDM i ka terhequr vemendjen UKT dhe Bashkisë së Tiranës në lidhje me marrjen e disa masave thelbësore për sigurinë e kësaj dige edhe për vete faktin që kjo dige është objekt i rëndësise se vecante.

Problemet kryesore të hasura gjatë këtij kontrolli dhe monitorimi të digës së Bovillës dhe që kërkojnë zgjidhje nga shfrytëzuesi i digës janë:

- **Hartimin e planit të gadishmerisë në rastet e emergjencave civile** në zbatim të Ligjit Nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen Civile”, VKM nr. 147, datë 18.03.2004 “Rregullore për Sigurinë e Digave dhe Dambave”. Megjithë kërkesat e përsëritura të KKDM si dhe kërkesat ligjore për hartimin e planit të alarmit dhe evakuimit për digën e Bovillës që shfrytëzohet nga UKT/ Bashkia Tiranë akoma nuk ka kryer një **studim për përhapjen e valës në luginën poshtë digës, përcaktimin e hartës së përmbajtjeve në rastet e prurjeve të mëdha** me përsëritje 1 herë në 100 vjet dhe 1 njëherë në 1000 vjet apo prishjes së mundshme të digës.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- **Pregatitjen dhe dorëzimin pranë KKDM të dosjes teknike/ pasaportës së digës së Bovillës** me të gjithë dokumentacionin teknik të duhur të kërkuar në bazë të Udhëzimit Nr.4 të Këshillit të Ministrave, datë 18.07.2003 "Për Kërkesat e dokumentacionit ligjor dhe teknik që duhet të përmbajë dosja e digave dhe dambave" si dhe Vendimit Nr. 02. Date 21.09.2020 të KKDM. Pregatitja e dosjes teknike është mjaft thelbësore dhe e domosdoshme gjatë monitorimit dhe mirëmbajtjes së të gjithë elementeve të digës në kuadër të sigurisë së saj;
- **Pregatitjen dhe dorëzimin pranë KKDM të Rregullores së shfrytëzimit të digës së Bovillës** në përputhje me Udhëzimin e përgjithshëm të aprovuar me vendimin e KKDM Nr. 3, date 19.10.2020. Pregatitja e Rregullores së shfrytëzimit përveç se është një detyrim ligjor është mjaft e rëndësishme gjatë monitorimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së të gjithë elementeve të digës në kuadër të sigurisë së saj.
- **Instalimin e një sistemi monitorimi modern** në digën e Bovillës si dhe të një sistemi monitorimi në zonën e masivit rrëshqitës në afërsi të digës.
- **Instalimin e një sistemi alarmi** sipas eksperiencave bashkëkohore në Shqipëri dhe në Europë.

Kontrolli, Monitorimi dhe siguria e digës së Manskurisë në Kavajë kryhet nga një ekip teknik i UK Kavaje. Në këtë digë nuk ka të instaluar sisteme monitorimi, sisteme alarmi dhe UKK kryen vetëm kontrole vizuale të gjendjes së digës. Sipas informacioneve të dhëna nga Ndërmarrja UKK rezulton se trupi i digës vazhdon të ketë probleme rrëshqitje dhe filtrime të trashëguara nga e kaluara dhe deri me sot nuk janë marrë asnjë masë për rehabilitimin e tyre dhe kontrollin dhe monitorimin e gjendjes së saj. KKDM rekomandon në mënyrë të fuqishme pregatitjen e projektit të zbatimit për rehabilitimin e saj dhe një ndërhyrje sa më shpejt të jete e mundur.

- **Digat e mëdha që përdoren për Ujitje**

Sipas regjistrimit të KKDM, në vendin tonë aktualisht janë **331 diga të mëdha** që përdoren për ujitje dhe për atraksione urbane ku 8 prej tyre shfrytëzohen nga MBZHR dhe 323 diga të mëdha shfrytëzohen nga 55 pushtete lokale që i kanë marrë në administrim përmes VKM Nr. 1108, date 30.12.2015. Në vitin 2009, me financim të Bankës Botërore është kryer një studim për gjendjen e 195 digave të mëdha që përdoren për ujitje. Bazuar në këtë studim gjatë kësaj periudhes 10 vjecare janë kryer rehabilitimi i me se 11 prej tyre por në asnjë rast nuk janë instaluar sisteme të monitorimit të digave apo sistemet e Alarmit të tyre. Te gjitha digat e mëdha që përdoren për ujitje nuk kanë të instaluar sistemet e alarmit duke qenë se ne shkelje të kërkesave ligjore në fuqi.

Gjithashtu në vitin 2021, me financimin e Bankës Botërore është kryer një studim i plotë për përmirësimin e sektorit të ujitjes dhe kullimit ku në një pjesë të mirë të këtij studimi është kryer një analizë për gjendjen e digave dhe masat që duhet të merren për përmirësimin e gjendjes së tyre. Sipas këtij studimi është konkluduar se me se 400 diga kanë nevojë për kryerjen e punimeve rehabilituese dhe riparuese të strukturave hidraulike dhe 70 prej këtyre digave kanë dalë jashtë funksionit dhe duhen përgatitur projekte për dekomisionimin e tyre. Kosto e rehabilitimit të këtyre digave apo dekomisionit të tyre është afro 130 milion USD



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

○ **Digat e mëdha për ujitje që shfrytëzohen nga MBZHR**

Kontrolli, Monitorimi dhe siguria e këtyre digave kryhet nga ekipe teknike të 4 bordeve të kullimit të MBZHR që ndodhen në Fier, Durrës, Korçë dhe Lezhë. Këto ekipe kryejnë vetëm kontrole vizual sipas kërkesave teknike të hartuar nga MBZHR por nuk kryejnë monitorim bashkëkohor të tyre. Ne kuader të projektit të financuar nga BB janë instaluar instrumenta të monitorimit të digave në 4 prej këtyre digave por akoma nuk është hartuar ndonjë program monitorimi të tyre nga bordet e kullimit të MBZHR.

Bazuar në Informacionet e marra si dhe nga kontrollet e ushtruara në terren nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në lidhje me problematikat e hasura gjatë shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes të digave të Ujitjes të administruara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, verëhet se:

- **Mungojnë Planet e gadishmërisë në rastet e emergjencave civile** për të gjitha digat që janë nën administrimin e MBZHR, në zbatim të Ligjit Nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen Civile” dhe VKM nr. 147, datë 18.03.2004 “Rregullore për Sigurinë e Digave dhe Dambave” Megjithë kërkesat e përsëritura të KKDM si dhe kërkesat ligjore për hartimin e planit të gadishmërisë në rastet e emergjencave civile për digat që shfrytëzohen nga kjo Ministri, akoma nuk është dërguar ndonjë dokument i tillë pranë KKDM. Duke patur parasysh rrezikun në raste të dëmtimit apo prishjes së mundshme të ndonjë digë kërkohet të hartohen planet e alarmit dhe të evakuimit duke përfshirë edhe studimin për perhapjen e vales shkatërruese në luginën poshtë digës sipas kërkesave teknike si dhe hartimin e planit të gadishmërisë në rastet e emergjencave civile.
- **Mungojnë disa sisteme të monitorimit të digave sipas kërkesave teknike dhe rekomandimeve të ICOLD si dhe matjet e monitorimit sizmik, gjeologjik, hidraulik dhe hidrometeorologjik apo të dhëna të tjera** në lidhje me uljet e mundshme, filtrimet, rrëshqitjet, lëkundjet sizmike, etj në trupin e digave dhe në shpatet e tyre. Njohja e fenomeneve që ndodhin në diga si dhe të gjëndjes së tyre shërben jo vetëm për rritjen e sigurisë së digave por edhe për analizimin e problematikave që mund të kenë ndodhur gjatë viteve të operimit dhe shfrytëzimit të saj. Kjo lidhet edhe me faktin e moshës së vjetër të ndërtimit të këtyre digave shumica e të cilave janë ndërtuar me shumë se 50 vite me parë dhe me teknologji të vjetëruar të viteve 1960-1970. Problematika behet me e madhe duke u nisur edhe nga fakti i mosmirëmbajtjes dhe monitorimit të tyre si dhe nga fakti i popullimit të zonës urbane poshtë tyre.
- **Mungojnë sistemet e alarmit në trupin e digave** sipas eksperiencave bashkëkohore në Shqipëri dhe në botë. Duke patur parasysh ndërtimet e shumta në zonën poshtë digave si dhe numrin e madh të njerezve në rrezik që banojnë poshtë tyre, instalimi i sistemeve të tilla moderne është një domosdoshmëri urgjente dhe ligjore.
- **Mungojnë matjet e sedimenteve në rezervuarët e krijuar nga këto diga dhe kryerja e matjeve batimetrike të volumeve të ujëmbledhësit.** Megjithatë sipas VKM Nr. 147, datë 18.03.2004, neni 30, këto matje duhet të bëhen të paktën një herë në 10 vjet, deri më sot janë kryer vetëm në digën e Janjarit dhe të Thanës por pa kryer një analizë dhe konkluzion në lidhje me situatën aktuale .

Për sa më sipër, KKDM ka kërkuar zyrtarisht marrjen e Masave përkatëse për zgjidhjen e problematikave të mësipërme të shoqëruara me një program të detajuar pune për realizimin e këtyre masave të kërkuara me sipër në përputhje me legjislacionin në fuqi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

○ **Digat e mëdha për ujitje dhe zhvillim urban të shfrytëzuara nga Bashkia e Tiranës**

Bashkia e Tiranës është shfrytëzuesi më i madhe i digave të ujitjes dhe për qëllime urbane duke patur nën administrim **38 diga te medha (Diga e Liqenit artificial te Tiranës administrohet nga UKT)**. Kontrolli, Monitorimi dhe siguria e këtyre digave kryhet nga nje sektor teknik I Bashkise Tiranë. Këto ekipe kryejnë vetëm kontrolle vizual por në asnje digë nuk kanë të instaluar sisteme te monitorimit të digave apo sisteme alarmi.

Bazuar në Informacionin e dërguar nga ana e Bashkisë Tiranë në KKDM si dhe nga takimet dhe kontrollet e ushtruara në terren nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në lidhje me problematikat e hasura gjatë shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes të digave të medha të shfrytëzuara nga Bashkia Tiranë dhe UK Tirana, verëhet se:

- **Per te gjitha digat e medha, Mungojne hartat e permbytjeve ne rastet e prurjeve te medha apo prishjes se mundshme te digave** si dhe Planet e gadishmerise ne rastet e emergjencave civile. Duke patur parasysh popullimin e zonave urbane poshte digave si dhe rrezikun e demtimeve apo humbjeve te njerezve ne rastet e eventeve natyrore qe mund te ndodhin nga demtimet dhe prishjet e ketyre digave kerkohet me urgjence pregatitja e hartave te permbytjeve dhe planet e gadishmerise ne rastet e emergjencave civile. **Kjo vlen per tu theksuar ne menyre te vecante per zonen urbane poshte diges se Liqenit artificial te Tiranës** e cila sic dihet qe prej ngjarjes se vitit 2010 akoma nuk jane marre masa per rehabilitimin e shkarkuesit katastrofik te diges. Gjithashtu, theksojme se ne kete zone ka edhe shume ndertime poshte diges te cilat mund te jene me pasoja te medha ne rast te demtimit apo prishjes se saj
- **Mungojne sistemet e alarmit në trupin e digave** apo sistemet e lajmerimit te termeteve sipas eksperiencave bashkekohore ne Shqiperi dhe ne bote. Duke patur paraysh ndertimet e shumta ne zonen poshte digave si dhe numrin e madh te njerezve ne rrezik qe banojne poshte tyre, instalimi i sistemeve te tilla moderne eshte nje domosdoshmeri urgjente dhe ligjore.
- **Mungojnë Sistemet e monitorimit të digave sipas kërkesave teknike dhe rekomandimeve të ICOLD si dhe matjet e monitorimit gjedoezik, sizmik, gjeloggjik, hidraulik dhe hidrometeorologjik apo të dhëna** në lidhje me uljet e mundshme, filtrimet, rrëshqitjet, lëkundjet sizmike, etj në trupin e digave dhe ne shpatet e tyre. Njohja e fenomeneve qe ndodhin ne diga si dhe te gjendjes se tyre sherben jo vetem per rritjen e sigurise se digave por edhe per analizimin e problematikave qe mund te kene ndodhur gjate viteve te operimit dhe shfrytezimit te saj. Kjo lidhet edhe me faktin e moshes se vjeter te ndertimit te ketyre digave shumica e te cilave jane ndertuar me shume se 50 vite me pare dhe me mosmirembajtjen e duhur ne vite.
- **Mungojne matjet e sedimenteve ne rezervuaret e krijuar nga keto diga dhe kryerja e matjeve batimetrike të volumeve të rezervuareve te krijuar nga keto diga.**
- **Mungojnë Dosjet teknike të me se 10 digave të mëdha të shfrytëzuara nga Bashkia Tiranë**

Për sa më sipër, KKDM ka kërkuar zyrtarisht marrjen e Masave përkatëse për zgjidhjen e problematikave të mësipërme të shoqëruara me një program të detajuar pune për realizimin e këtyre masave të kërkuara me sipër në përputhje me legjislacionin në fuqi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

## 5-Programi dhe Aktivitetet e KKDM gjatë vitit 2021

Bazuar në Urdhërin e Kryeministrit Nr.108, date 13.08.2020 si dhe në Urdhërin e Ministres së MIE të datës 11.09.2020, u be rikonstituimi i ekipit të KKDM dhe KTPD i cili sipas legjislacionit në fuqi përbehet nga 11 Antarë të KKDM dhe 5 antarë të KTPD. Prej Muajit Gusht 2020 me urdher të KM, Kryetar i KKDM është emëruar z. Arjan Jovani.

Në mbledhjen e datës 15.02.2021, KKDM shqyrtoi dhe miratoi programin e punës dhe aktivitetet e KKDM për vitin 2021 duke patur parasysh jo vetëm organizimin e mbledhjeve të rregullta mujore gjatë të gjithë vitit nën drejtimin e Kryetarit të saj për të marrë vendime lidhur me të gjithë funksionet dhe detyrat e ngarkuara sipas legjislacionit në fuqi. Njëkohësisht në program u parashikuar edhe takime pune me shfrytëzuesit e digave, vizita në terren për gjendjen aktuale të tyre dhe problematikat që mund të hasen si dhe shkëmbime me aktoret kryesore institucionale në nivel qendror qeverisje si KM, MIE, MBZHR, Ministria e Mbrojtjes/Agjencia e Mbrojtjes civile, AMBU, Prefekturat, etj

Për Realizimin e detyrave, KKDM është ndihmuar dhe mbështetur nga Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave si organ këshillimor i tij.

Bazuar në programin e mësipërm gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2021, KKDM ka kryer një sere aktivitetesh kryesore në lidhje me kontrollin e gjendjes aktuale të digave, hartimin e Udhëzimeve dhe Rekomandimeve të nevojshme për ecurinë e procesit të monitorimit dhe sigurisë së digave duke i paraprirë disa problematikave të hasura në terren.

Gjate kësaj periudhe janë marre 30 Vendime të KKDM ndër me kryesoret mund të permendim:

- Aprovimi i Klasifikimit të digave në varesi të pasojave në zonat poshte digave
- Aprovimi i Projektit të zbatimit për instalimin e sistemit fotovoltaik në digën e Qyrzaqit të HEC Vau i Dejes
- Shqyrtimi I problematikes së uljeve në digën e HEC Moglices.
- Aprovimi i Planeve të Gadishmerisë në rastet e emergjencave civile për shkak të prishjeve të mundshme të digave të HEC Fanit, Ulez, Shkopet, Bistrice 1, Fierze, Koman, Vau I dejes
- Aprovimi i drafteve të 2 buletineve të ICOLD në lidhje me sigurinë e digave
- Aprovimi i projektit të zbatimit për Rehabilitimin e digës së Peze Gjyslikone
- Aprovimi i Rregjistrimit Kombëtar të digave të mëdha që shfrytëzohen gjatë vitit 2021
- Shqyrtimi I Raportëve vjetorë të përgatitura nga MBZHR, Bashkia Tirane dhe Hydroenergji

Gjithashtu në mbledhjet e KKDM janë marre në shqyrtim problematika e shfaqur me uljet lokale në kreshten e digës së Moglices pas mbushjes së parë me ujë të rezervuarit të cilat për mendimin e KKDM është problematike duke u krahasuar me stadartet dhe përvojat bashkohore në Europë dhe Japoni dhe kërkon një vëmendje. Për këtë çështje i është kërkuar Shfrytëzuesit të digës të japë informacion me të hollësisht, analize dhe monitorim të detajuar të bazuar jo vetëm në të dhënat e siguruar në terren me anë të matjeve me pajisjet e cilesisë së lartë por edhe me analiza dhe krahasime me raste të ngjashme që mund të kenë ndodhur në vendet e Europës me eksperiencë në këtë drjetim.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Per vete rendesine e kesaj dige, KKDM ka kerkuar Shfrytezuesit, te kryeje analizat teknike perkatese te ketij rasti ne bashkepunim me ekipin e projektuesit si dhe duke angazhuar ekip te specializuar per keto lloj diga.

Gjate kesaj periudhe jane organizuar vizita ne terren si dhe disa takime pune me ekspertet e kompanise Devolli HP e cila ka konfirmuar qe kjo problematike eshte trajtuar me vemendjen maksimale nga ekspertet e saj. Gjithashtu, Shfrytezuesi i diges duhet te dorezoje cdo 6 muaj Raporte teknike te vecanta me te dhenat dhe analiza gjithepershires ne lidhje me kete problematike

Ndër aktivitetet kryesore te zhvilluara gjate kësaj periudhe kane qene edhe Takimet e punes ne MBZHR, AMBU, ASIG, Akademe e Shkencave te Shqiperise si dhe me perfaqesues te Prefektures Tirane, Bashkise Tirane, Korce, Durres, Shijak, etj

Bazuar ne programin e aprovuar, per here te pare ne vitin 2021 ne bashkepunim me AKSHI eshte hapur faqja e Internetit e KKDM e cila do jete nje dritare per te gjithë aktoret ne kete fushe dhe do te sherbeje si mjet komunikimi dhe informacioni per legjislacionin ne sektorin e digave, aktivitetet e KKDM, Historine e ndertimit dhe shfrytezimit te digave te medha, etj

Ne bashkepunim me EUROCOLD, eshte hartuar nje Raport per legjislacionin e digave ne Europe ku Shqiperia eshte perfshire per here te pare ne 20 vendet europiane me informacion bashkekohor ne kete sektor

Ne Nendor 2021 kryetari I KKDM mori pjese ne takimet online te ICOLD dhe EUROCOLD ku u diskutuan ceshtje te rendesishme per sigurine e digave dhe u aprovuan disa buletine te reja te pregatitura nga komitetet teknike perkatese te ketyre organizatave

Ne Dhjetor 2021, KKDM ne bashkepunim me Akademe e Shkencave organizoi nje simpozium per digat e medha qe perdoren per prodhim Hidroenergji. Ky aktivitet u shoqerua edhe me hapjen e nje ekspozite fotografike te 24 digave qe jane ne operim dhe perdoren per prodhimin e energji se ujqore.

Gjithahstu, ne kuader te promovimit te ketij sektori dhe njohjes se inxhinierëve te rinj, gjate muajit Dhjetor u organizuan leksionet e hapura per digat e hidroenergji se ne Universitetin Politeknik te Tiranës, Universiteti Polis, Universiteti Epoka, Universiteti Metropolitan, etj



## 6- Përfundime dhe Rekomandime kryesore

Në aktivitetet e kryera gjate vitit 2021 krahas punes se kryer per ndjekjen e vazhdueshme te situates ne drejtim te permiresimit te kushteve te mirembajtjes, shfrytezimit, monitorimit dhe sigurise se digave qe jane ne shfrytezim, eshte vene re nje pune e mire e Disa shfrytezuesve te digave qe perdoren per prodhim energjie dhe per ujitje,

Gjate zhvillimit te aktiviteteteve zyrtare, institucionale dhe organizative si dhe njohjes ne terren ne gjendjes, i KKDM ka hasur edhe ne shume problematika te cilat **kerkojne zgjidhje sa me te shpejta permes kryerjes se nje reforme te thelle ne sektorin e shfrytezimit, monitorimit, mirembajtjes dhe Sigurise se digave te medha ne Shqiperi.**

Konkretisht:

- **Ligji Nr. 8681, date 02.11.2000 “Per projektimin, ndertimin, shfrytezimin, dhe mirambajtjen e digave dhe dambave” si dhe VKM Nr.147, date 18.03.2004 “Per miratimin e rregullores per sigurine e digave dhe dambave” duhet te perditesohen ne funksion te kushteve dhe zhvillimeve te reja ne sektorin e digave. KKDM rekomandon se legjislacion eshte e domosdoshme te perditesohet duke perfshire klasifikimin e digave sipas rrezikut ne zonat poshte tyre, kerkesat teknike per rehabilitimin e tyre, kerkesat per shfrytezuesit e digave ku shumica e tyre jane pushtetet lokale dhe kompani private, pershtatjen me ligjet e reja qe lidhen me sigurine e digave, organizimin e KKDM dhe institucioneve ne varesi te saj si dhe masat perkatëse penalizuese per shfrytezuesit e digave qe nuk plotësojne kerkesat e ligjit ne fuqi**
- **Inspektoriati teknik i Digave nuk funksionon.** Theksojmë se mungesa e ketij Institucioni qe duhet te jete nen varësinë e MIE, ka krijuar probleme te medha sidomos ne kontrollin e punimeve te rehabilitimit te digave dhe ne kolaudimine tyre, ne kontrollin e monitorimit te digave gjate shfrytezimit te tyre si dhe ne informacionin per gjendjen e digave qe duhet te jete prane KKDM. **KKDM rekomandon se në bashkëpunim me MIE, është e nevojshme të rishikohen dhe të plotësohen aspektet e kërkuara në ligjin ekzistues për funksionimin e të gjitha institucioneve të parashikuara në të (SKDM, ITD, KTPD).**
- Shumica e Shfrytezuesve te digave te medha qe perdoren per qellime ujitje nuk kane njesite e drejtimit teknik per sigurine dhe kontrollin e digave gjate shfrytezimit duke mos respektuar kerkesat e nenit 29 te VKM nr.147, KKDM ju ka kerkuar shfrytezuesve te digave te mesiperme **te krijojne urgjentisht pozicionin e Inxhinierit te diges/ njesise se drejtimit teknik per sigurine e digave** duke percaktuar ne menyre te qarte te gjitha detyrat dhe te drejtat e tyre gjate procesit te shfrytezimit, mirembajtjes, kontrollit, monitorimit dhe sigurise se diges.
- Shumica e shfrytezuesve te digave te medha qe perdoren per qellime ujitje nuk kane dosjet teknike te digave/ Pasaportat e digave. KKDM rekomandon se shfrytezuesit e ketyre digave ne bashkepunim me MBZHR duhet te organizojne procesin e pregatitjes se dosjeve teknike te ketyre digave. Ky proces duhet te shoqerohet edhe me nje proces per perditesimin e te dhenave teknike te ketyre dosjeve permes matjeve ne terren.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Ne bashkëpunim me ASIG, AMBU dhe KKDM është përgatitur harta e vendndodhjes së të gjithë digave të mëdha të shoqëruar me të dhënat kryesore teknike të kërkuara nga ICOLD. KKDM rekomandon që MBZHR në bashkëpunim me shfrytëzuesit e digave duhet të kryejë procesin e përgatitjes të hartës së vendndodhjes së afro 300 digave të vogla që janë përcaktuar në Inventarin e përgatitur nga kjo Ministri në vitin 2015
- Mungon Vleresimi i asetëve të digave që shfrytëzohen nga pushteti lokal. KKDM rekomandon që shfrytëzuesit e digave në bashkëpunim me prefekturat dhe MBZHR të fillojnë procesin e vleresimit të këtyre asetëve dhe të hartohet një regjistër kombëtar i vlerësimit të këtyre asetëve
- Vetëm në 12 diga të mëdha që përdoren për prodhim energjie ka të instaluar sisteme alarmi në diga dhe janë të përgatitura hartat e permbytjeve për zonat e poshtme të digave në rastet e demtimeve të mundshme të tyre gjatë ngjarjeve katastrofike të natyrës apo të shfrytëzimit të tyre. **95 % e digave të mëdha nuk kanë të instaluar sisteme alarmi në diga. Me e theksuar kjo problematike është në digat që administrohen nga MBZHR dhe nga shfrytëzuesit (Bashkitë) e digave të mëdha që përdoren për qëllime ujëtare.**
- Shfrytëzuesit e 95 % e digave të mëdha që përdoren për ujëtare nuk kanë përgatitur hartat e permbytjeve në rastet e prishjeve katastrofike apo të prishjeve të mundshme të ndonjë dige duke mos respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi. KKDM rekomandon që kjo problematike duhet të zgjidhet sa më shpejt duke i përfshirë në procesin e përgatitjes së Planeve të Gadishmerisë në rastet e emergjencave civile. Përgatitja e këtyre hartave është e lidhur me masat që duhet të merren për sigurinë e banorëve që ndodhen në zonat urbane poshtë digave. Duke qenë se këto diga shfrytëzohen nga 55 bashki, theksojmë se përgatitja e hartave të permbytjeve dhe Planeve të Gadishmerisë mund të kryhet gjatë vitit 2022 duke përdorur fondet e dhëna nga buxheti i shtetit për emergjencat civile në çdo bashki.
- Shfrytëzuesi i digës së Moglicës (Devollit HP) duhet të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme të dhënat e uljeve në kurorën e digës së Moglicës sipas udhëzimeve dhe rekomandimeve të dhëna nga KKDM dhe të informojë me raporte teknike të vecanta çdo 6 muaj KKDM, MIE dhe Këshillin e Ministrave
- Shfrytëzuesi i digës së Komanit (KESH) duhet të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme të dhënat e filtrimeve në biefin e poshtëm të digës së HEC Koman sipas rekomandimeve të dhëna nga KKDM që prej fillimit të monitorimit të tyre duke dhënë edhe rezultatet e të dhënave të monitorimit, analizat teknike dhe perfundimet përkatëse në lidhje me ecurinë e filtrimeve në këto zone si dhe fenomenet shoqëruese që mund të ndodhin duke përfshirë edhe turbullsinë e këtyre ujërave apo ulje lokale në zone. KESH duhet të informojë me raporte teknike të vecanta çdo 6 muaj KKDM, MIE dhe Këshillin e Ministrave
- Në bashkëpunim me MBZHR dhe pushtetet lokale duhet të realizohen trainime të stafëve teknike për monitorimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e digave të mëdha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- KKDM rekomandon se shfrytëzuesit e digave në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes/Agjencia e Mbrojtjes Civile duhet të kryejnë trainime dhe praktika në terren për zbatimin e detyrave të kërkuara nga Planet e gadishmërisë në rastet e emergjencave civile
- **Mungojnë standartet teknike për rehabilitimin e digave, për Monitorimin dhe Sigurinë e digave, për dekomisionimin e digave që janë jashtë funksionit, ndertimin e digave me material RCC si dhe kërkesat teknike në drejtim të mbrojtjes antisizmike gjatë projektimit dhe ndertimit të veprave hidroteknike dhe digave të mëdha** KKDM rekomandon që në bashkëpunim me Institucione dhe kompani konsulente të hartohen standarte teknike të mësipërme duke u bazuar në rekomandimet e ICOLD dhe në standartet teknike të vendeve europiane me eksperiencë në këtë fushë.
- **Shfrytëzuesit e digave të mëdha që përdoren për ujë nuk kanë matur volumin e ujit në rezervuarët e krijuar nga këto diga që prej më se 30 vitesh duke mos respektuar kërkesat e nenit 30 të VKM Nr.147, datë 18.03.2004 sipas të cilës këto matje duhet të ekryhen jo më vonë se çdo 5 vjet. Kjo kërkesë është urgjente edhe për faktin se sipas inspektimeve në terren, volumi I ujit në këto rezervuare vlerësohet të jetë me pak se 50 % e volumit të projektuar për shkak të sedimenteve të ardhura në to duke krijuar probleme në sasine e ujit që kërkohet për ujitjen e tokave poshtë këtyre digave. KKDM rekomandon që kjo problematikë duhet të zgjidhet përmes kryerjes së matjeve batimetrike në rezervuarët e krijuar prej tyre për të patur një pasqyrë aktuale të volumeve të ujit dhe për të hartuar një bilanc real të rezervave ujore të tyre.**
- Duke patur parasysh problematikën e konstatuar në më se 400 diga që përdoren për ujë në vendin tone, në faktin që afro 70 diga janë jashtë funksionit, në ndryshimet klimaterike të ndodhura vitet e fundit, në kërkesat për mbrojtjen e mjedisit, mungesën e stafëve teknike të kualifikuara prane bashkive që janë shfrytëzuesit kryesorë të digave, kërkesat për kërkime shkencore në drejtim të përmirësimit të ujitjes së tokave dhe mbrojtjes nga permbytjet, KKDM rekomandon krijimin e një institucioni tekniko shkencor apo projektues prane MBZHR ose MIE për zgjidhjen e problemeve të mësipërme në sektorin e digave.
- Duke u nisur nga situata aktuale e gjendjes së digave për qëllime ujë, KKDM rekomandon që MBZHR në bashkëpunim me pushtetet lokale duhet të përgatitë inventarin e digave që kanë dalë jashtë funksionit dhe kanë nevojë për projektet e duhura për dekomisionimin e tyre. KKDM do të ndihmojë dhe mbështetë me hartimin dhe aprovimin e standarteve teknike përkatëse të bazuar në rekomandimet e ICOLD dhe në eksperiencat me të mira europiane në këtë drejtim. MBZHR duhet të marrë masat e duhura për të kryer kontrollin dhe analizën teknike të specializuar me ekspertë të kualifikuar për të gjitha digat për qëllime ujë me vjetërsi mbi 50 vjetecare.
- KKDM rekomandon që shfrytëzuesit e digave që përdoren për qëllime të ujë duhet të bëjnë klasifikimin e digave sipas rrezikut të tyre në zonat urbane që ndodhen poshtë tyre duke u bazuar në Vendimin Nr. 15, datë 15.02.2021, shtojca 1 të KKDM.